



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi ..... nga ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-2530 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2530/1 me datë 24.04.2019, dorëzuar nga parashtruesi ..... nga .....,  
**NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-2530 nga viti 2019, për rastin e lëndës është vepruar nga organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-2530 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-2530 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-2530/1 me datë 24.04.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi ..... nga .....

Në denoncim flitet për akuza për parregullsi dhe punë joligjore të personave përgjegjës – drejtor i SHMK ..... nga ....., ..... dhe i drejtorit të SHF ..... në procedurën për zgjedhje/transfet të mësimdhënësit të lëndës së edukatës fizike dhe shëndetësore në SHF të përmendur.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Inspektorati shtetëror i arsimit edhe deri tek shkolla fillore e lëndës për informacione dhe të dhëna në lidhje me akuzat e denoncimit. Pas kërkesë së KSHPK janë dorëzua lajmërimet për inspektime e bëra dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për sjellje joligjore dhe keqpërdorime të autorizimeve diskrecione gjatë vendimmarrjes për zhvendosim të kontratës për punësim me përjashtim nga ana e punëdhënësit SHMK ..... nga ..... dhe oferta për kontratë të re të ndryshuar për punë, për personin ..... nga ....., i punësuar në shkollën në të cilën i janë shkelur të drejtat e tij të marrëdhënjes së punës dhe me të cilat parashtruesi i denoncimit, ka qenë i dëmtuar përshkak të së cilës i janë marrë

orët mësimore dhe i është zvogëluar fondi i orëve me atë edhe i është zvogëluar rroga, si dhe akuza për mosveprim të drejtorit të SHF ..... , pas vendimit me obligim për veprim të Inspektoratit shtetëror të arsimit e cila ka qenë parashtruar pas inspektimit të bërë në shkollën e lëndës.

Për këtë rast parashtruesi u drejtua dhe morri përgjigje nga Inspektorati shtetëror i arsimit - i cili me datë 27.03.2019 bëri inspektim të jashtëzakonshëm për ankesën e tij dhe morri Vendim me të cilën e obligon drejtorin e shkollës të drejtohet deri tek Kryetari i komunës dhe Sektori për arsim të Komunës dhe orët t'i plotëson me kuadro arsimore të punësuar me fond të vogël të orëve nga shkollë tjetër në nivel të komunës. Drejtori i shkollës fillore ..... - ..... nuk veprroi sipas Vendimit kurse në shkollë tjetër ku ka pasur fond të lirë të orëve ka angazhuar person me kontratë në vepër, në vend që t'i ndanë orët – gjë që është në pajtim me ligjin. Përshkak të kësaj ai ka kërkuar inspektim të jashtëzakonshëm deri tek Inspektorati i arsimit dhe i njëjti bëri inspektim dhe përsëri është marrë vendim që obligon drejtorin. Mirëpo edhe pas këtij vendimi drejtori nuk ka vepruar.

Nga ana e parashtruesit të denoncimit është vulosur edhe proces gjyqësor në vitin 2018, kundër SHMK ..... nga ..... , i cili ka përfunduar me akt-gjyqësor me datë 27.12.2018 me të cilën kërkesë për padi është rrefuzuar si e pa bazë, duke u thirrur në shfrytëzimin e të drejtës diskredituese të drejtorit.

- Me datë 03.02.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Inspektorati shtetëror i arsimit me shtojcë dokumentacion dhe me të cilën informon se nga ana e Këshilltarit – inspektori shtetëror i arsimit ..... është vepruar pas ankesës së dorëzuar nga ana e parashtruesit dhe është bërë inspektim i jashtëzakonshëm në SHF ..... dhe është përpiluar procesverbal dhe Vendim i vulosur me nr ..... me datë 27.03.2019 me lëndë për inspektim: procedura për zgjedhje të mësimdhënësit për arsim fizik dhe shëndetësor në SHF të përmendur. Gjatë inspektimit janë konstatuar parregullësi (nuk është vepruar në përputhje me rekomandimet e MASH) dhe me vendim është obliguar drejtori të ndërmerr masa dhe aktivitete për tejkalim të të njëjtave, kurse parashtruesi ..... është udhëzuar që nëse nuk është i kënaqur nga përgjigjja e marrë të drejtohet deri tek organi kompetent dhe të ngre procedurë pranë gjykatës themelore kompetente në ..... Është bërë edhe vëzhgim kontrollues me datë 17.04.2019 gjatë së cilës është konstatuar se shkolla ka vepruar sipas Vendimi të inspektoratit të dhënë gjatë inspektimit të jashtëzakonshëm dhe zgjedhja e mësimdhënësit për arsim fizik dhe shëndetësor në vend të personit ..... është bërë me personin ..... me fond më pak të orëve i punësuar në SHMK ..... dhe në përputhje me tregimet nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës nr. ....1 me datë 23.08.2018. Për të njëjtën është kompetuar edhe dookumentacioni dhe është nënshkruar kontrata për transfer nga SHMK..... - ..... me fond të plotë të orëve në SHF ..... Përshkak të kësaj Personi përgjegjës – drejtori i SHF ..... plotësisht ka vepruar sipas vendimit të marrë kundër të cilës nga ana e këshilltarit – inspektor shtetëror i arsimit nuk janë ngritur kallëzime penale ose procedurë për kundrëvajtje.
- Me datë 22.02.2020 deri tek KSHPK është dërguar përgjigje nga drejtori i SHF ..... me të cilën informon se nga ana e drejtorit në tërësi është plotësuar obligimi nga Vendimi i Inspektoratit shtetëror të arsimit nga data 29.03.2019 me numër të arkivës .....

e cila është marrë pas inspektimit të jashtëzakonshëm të bërë me datë 27.03.2019 nga ana e Inspektoratit shtetëror të arsimit - ..... për mënyrën dhe procedurën e bërjes së zgjedhje së mësimdhënësit për arsim fizik.

Në bazë të kësaj gjendje fizike të caktuar, KSHPK konstaton se në rastin e lëndës është vepruar nga ana e organit kompetent, inspektorati shtetëror i arsimit, i cili ka bërë inspektim dhe vëzhgim kontrollues në shkollën e përmendur kurse përshkak të kësaj nga ana e personit përgjegjës – drejtori i shkollës, në mënyrë të plotë është vepruar sipas Vendimit nga inspektimi i bërë, nga ana e këshilltarit – inspektori shtetëror i arsimit nuk janë ngritur procedura penale ose të kundërvajtjes në rastin e lëndës. Njëherit, për rastin nga ana e parashtruesit janë shfrytëzuar mjetet juridike dhe është vulosur proces gjyqësor në vitin 2018, kundër shkollës së përmendur në të cilën Gjykata, duke u thirrur në shfrytëzimin e të drejtës diskrecione të drejtorit të shkollës së lëndës, ka marrë akt-gjykim me datë 27.12.2018 në të cilën kërkesa e tij për padi rrefuzohet si e pabazë. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi  
Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: m-r Sh. S., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ KORRUPTIONIT**  
Zëvendës-Kryetarë: Shemshi Sallai